

VENDIM
Nr. 329, datë 28.5.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 672, DATË 7.8.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE, BURSAT E SHTETIT DHE
PAGESAT E NXËNËSVE E TË STUDENTËVE NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, PËR
VITIN SHKOLLOR 2013-2014”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 19 e 28, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 57 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 1 e 5 të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 29 të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002, “Për arsimin dhe formim profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 185/2013, datë 27.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 14 e vendimit nr. 672, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“14. Afati përfundimtar për paraqitjen e kërkesave për bursa pranë këshillave bashkiakë apo të komunës do të jetë data 15 dhjetor 2013, për të gjitha kategoritë e shkollave/institucioneve të arsimit të lartë, ndërsa për vitin e dytë e lart do të jetë data 15 nëntor 2013. Miratimi i bursave nga këshillat bashkiakë apo të komunës për këtë vit shkollor për të gjitha kategoritë e shkollave/institucioneve të arsimit të lartë duhet të përfundojë deri në datën 30 maj 2014.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama